

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas largimit nga turneu i Ed Sheeran, Macklemore bën gjestin e madh? Dhuron... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/pas-largimit-nga-turneu-i-ed-sheeran-macklemore-ben-gjestin-e-madh-dhuron/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 22:04:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 22:03:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d174f04c230502e1ee5f56ad9e6e9b90bdf6b3b937ef8205daffa49f4ef2dc3d
TEKSTI	3420a2ef56c18d8a009ecf3bca780ad5dd28db2501dde7ab3d5ad162938e8807
PAMJA	d1557e347f65f66decbb82c2e03d009ec548184658008f9578457943f3fd9933

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9693d0cbe3930f7339ef2bd37cec009d9042026343b273f038eec1188106768b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5345adcd1aa94d26a715684b051fd1b2f60064832993062139e0dcea4687825f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9693d0cbe3930f7339ef2bd37cec009d9042026343b273f038eec1188106768b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Pas largimit nga turneu i Ed Sheeran, Macklemore bën gjestin e madh? Dhuron...



Redaksia K

17 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Vetëm pak ditë pasi u përjashtua nga turneu i Ed Sheeran pas deklaratave të tij publike në mbështetje të Palestinës, Macklemore ka njoftuar se do të dhurojë të gjithë shumën prej 1 milion dollarësh që fitoi nga pjesëmarrja në turne për organizata që ndihmojnë popullin palestinez.

Reperi amerikan e bëri të ditur vendimin përmes një deklaratë në Instagram, ku tha se dëshiron që vëmendja të rikthehet te njerëzit që po përballen me pasojat e luftës dhe krizës humanitare në Gaza.



Me gjithçka që ka ndodhur gjatë 48 orëve të fundit, dua ta rikthej bisedën aty ku duhet të jetë: te populli palestinez

-shkroi Macklemore, duke njoftuar se do të dhurojë të gjithë fitimin e tij neto prej 1 milion dollarësh nga "Loop Tour" për gjashtë organizata që punojnë drejtpërdrejt në mbështetje të palestinezëve.

Fondet do të shkojnë për Palestine Children's Relief Fund, HEAL Palestine, Gaza Soup Kitchen, Medical Aid for Palestinians, UNRWA USA National Committee dhe Anera.

Por **Macklemore** nuk u ndal vetëm te njoftimi për donacionin. Ai i bëri një sfidë publike edhe Robert Kraft, pronarit të New England Patriots dhe Gillette Stadium, i cili kishte kundërshtuar performancën e reperit në stadiumin e tij.

Macklemore e ftoi Kraft-in që të përputhë donacionin e tij prej 1 milion dollarësh, duke argumentuar se, pavarësisht mosmarrëveshjeve mes tyre, mund të bien dakord për rëndësinë e mbrojtjes së ietëve palestineze.

“ Një jetë palestineze nuk është më pak e vlefshme se çdo jetë tjetër në këtë tokë

-shkroi reperi në deklaratën e tij.

Macklemore u largua nga pjesa e mbetur e **turneut të Ed Sheeran** pasi gjatë një koncerti në MetLife Stadium në New Jersey shprehu publikisht mbështetjen për Palestinën dhe bëri thirrje për “Free Palestine”. Pas kësaj, disa prej ambienteve ku ishin planifikuar koncertet e ardhshme kundërshtuan vazhdimin e tij si artist mbështetës.

Ed Sheeran ka deklaruar se vendimi për largimin e Macklemore nuk ishte i tij, por i promovuesit dhe ambienteve ku do të zhvilloheshin koncertet. Sipas Sheeran, disa stadione kishin paralajmëruar se do të anulonin shfaqjet nëse Macklemore do të vazhdonte të ishte pjesë e turneut.

Pas largimit të reperit, polemika u zgjerua edhe më tej. Artistët Finneas, Lukas Graham, Aaron Rowe dhe Beoga njoftuan se nuk do të merrnin pjesë në pjesën e mbetur të turneut, në shenjë solidariteti me Macklemore.

Në deklaratën e tij të fundit, Macklemore theksoi se donacioni nuk duhet të shihet si diçka që e vendos atë në qendër të historisë.

Ai tha se dëshiron të fokusohet te prindërit që përballen me humbjen e fëmijëve, mjekët, gazetarët, punonjësit humanitarë dhe aktivistët që vazhdojnë të punojnë në kushte të vështira.

LAJME TË NGJASHME



Ed Sheeran thyen heshtjen për largimin e Macklemore nga turneu: “Nuk ishte...”

3.5 MIN



Çfarë ndodhi? Muzikanti irlandez tërhiqet nga turneu i Ed Sheeran!

2.5 MIN



Macklemore largohet nga turneu i Ed Sheeran, por nuk pendohet? Pse?

3.5 MIN



Ministri i Jashtëm izraelit: Nuk kemi plane për dëbimin e palestinezëve nga Gaza

1.5 MIN



Bordi i Paqes/ Zyrtari i Hamasit pranon marrëveshjen: Kemi aprovuar planin për çarmatimin e plotë në Gaza

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Sot verdikti i Hagës/ Konjufca: Presim vetëm një vendim, lirim



Charles Smith kryeson trupin gjyqës në Hagë



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Trupi gjyqës: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht



Gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thačin dhe ish-

e katër ish-krerëve të UÇK-së

përgjegjës për krime lufte


krerët e tjerë të UÇK-së



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim



Hago/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Kush janë gjyqtarët që do të shpallin sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së në Hagë?



Nis seanca në Hagë për shpalljen e vendimit për Thaçin, Veselin, Selimin e Krasniqin

EDITORI SUGJERON



10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të vicit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!



Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qesharake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës...



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



"Në fillim nuk kam patur ndonjë..." / Lorenc Hasrama kujton pjesëmarrjen në "The Voice of Albania"!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.